

---

**STATUTI  
I SHOQERISE TREGTARE  
“ALCO-SYSTEMS” Shpk**

---



**HYRJE**

1.1

**Palet**

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar:  
“ALCO-SYSTEMS” Shpk, krijohet mbi bazen e iniciatives  
dhe kapitalit te ortakeve te meposhtem:

**Irfan Hysenbelliu** i datelindjes 8.4.1959, lindur ne Skrapar, me banim  
ne rrugen “Pjeter Bogdani”, P.11, Ap.6 , Tirane, madhor, me zotesi te  
plate juridike per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare ,  
mbajtes i pasaportes Nr.299990

**Sokol Hoxha**, i datelindjes 14.2.1951, lindur ne Tirane, me banim ne  
rrugen “Brigada e Tete”, Pall.8, Shk.3, Ap. 35, Tirane, madhor, me  
zotesi te plate juridike per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi  
shqiptare, mbajtes i leternjofimit Nr.EV 219111.

**Artur Dushku**, i datelindjes 31.5.1955, lindur ne Tirane, me banim ne  
rrugen “Labinoti”, Pall.2, Shk.6, Ap.48 Tirane, madhor, me zotesi te  
plate juridike per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare,  
mbajtes i pasaportes Nr.0026421



1.2 **Baza ligjore**



1.2.1 Shoqeria krijohet dhe e zhvillon veprimtarine e saj ne pajtim me rregullat e ketij statuti, te kontrates dhe te legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

1.2.2 Kjo shoqeri, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar i perballon humbjet deri ne kufirin e kapitalit themeltar.

2. **OBJEKTI**

Shoqerie Tregtare "ALCO-SYSTEMS" Shpk , do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

2.1 Sherbimet publike ne fushen e telekomunikacionit teleinformatikes dhe informatikes.

2.2 Import-eksporti i pajisjeve e pjeseve elektronike te telekomunikacionit dhe informatikes, te linjave dhe makinerive.

2.3 Veprmtaria e ndermjetesimit, agentit tregtar dhe komisionerit si dhe ajo e perfaqesimit te firmave te huaja.

2.4 Konsultimi, projektimi, riparimet dhe asamblimet e aparaturave elektronike, informatike dhe te telekomunikacionit si dhe instalimi dhe shfrytezimi i tyre.



3. **EMRI SELIA TERRITORI**

3.1 Emri i kesaj shoqërie do të jetë : **“ALCO-SYSTEMS” Shpk.**  
Shoqëria fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

3.2 Shoqëria e ka qendrën e saj në qytetin e Tiranës, ku do të zhvillohet dhe aktiviteti i saj kryesor. Selia e shoqërisë do të jetë në rrugën “Pjetër Bogdani”, Nr.23/1 Tiranë.

3.3 Shoqëria mund ta zhvillojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

3.4 Ajo mund të krijojë filiale ose perfaqësi edhe në rrethe të tjera të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.

4. **KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

4.1 Kapitali themeltar i shoqërisë perbehet nga kontributi i perbashkët i ortakëve themelues në shumën 100 000 Leke.

4.2 Perqindjet e secilit ortak në kapitalin janë :

Irfan Hysenbelliu	70 %
Sokol Hoxha	15 %
Artur Dushku	15 %

4.3 Nenshkrimi i statutit nga ortakët verteton shlyerjen e nga secili të kapitalit themeltar.

4.4

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose zvogelohet ne vartesi te rezultateve dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.



4.5

Kapitali themeltar mund te zmadhohet edhe nepermjet pranimi te ortakeve te tjere.

4.6

Kapitali themeltar mund te transferohet jashte shoqerise tek persona te tjere qe nuk bejne pjese ne shoqeri, ose te lihet peng, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

4.7

Kapitali themeltar mund te transferohet nga njeri ortak tek tjetri vetem me marreveshje te posaçme ndermjet tyre.

4.8

Shoqeria mund te kete dhe kontribute ne natyre. Ne kontribute ne natyre perfshihen te gjithë pasurite e paluejtshme si dhe çdo lloj makinerie dhe pajisjeje qe behet prone e shoqerise.

5.

## **FONDET E SHOQERISE**

5.1

Shoqeria percakton fondet e meposhtme :


1. Fondin themelor ( qarkullues )
2. Fondin rezerve
3. Fonde te tjera, te cilat mund te jene te nevojshme gjate veprimtarise.

5.2

Masa e secilit fond dhe menyra e perdorimit te tij, percaktohen me vendim te organit drejtues te shoqerise dhene perputhje me legjislacionin ne fuqi.

6.

**ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**



6.1

Organi me i larte drejtues i shoqerise eshte asambleja e ortakeve.

6.2

Asambleja e ortakeve, si rregull mblidhet nje here ne gjashte muaj. Ajo mund te mblidhet edhe me shpesh, kur nje gje te tille e kerkon ndonjeri prej ortakeve.

6.3

Per mbledhjen e asamblese, ortaket duhet te njoftohen te pakten 15 dite perpara me leter rekomande ose me faks. Ne mesazhin e njoftimit, duhet te jete percaktuar edhe rendi i dites.

6.4

Vendimet e asamblese se ortakeve merren me shumice votash, nese ne kete statut nuk eshte percaktuar ndryshe. Çdo ortak ka numrin e votave te barabarte me perqindjen e tij ne kapitalin e shoqerise.

6.5

Ndryshimet ne statutin e shoqerise, vendosen me  $\frac{3}{4}$  e votave.

6.6

**Kompetencat e asamblese se ortakeve:**

6.6.1

Zgjedh, emeron shkarkon administratorin ose administratoret e shoqerise.

6.6.2

Miratton politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.


6.6.3

Aprovon veprimet me te rendesishme juridike te shoqerise me persona te tjere juridike dhe fizike.

- 6.6.4 Shqyrton bilancet tremujore dhe vjetore dhe percakton kuotat e fondeve te ndryshme si dhe fitimin qe do t'u ndahet ortakeve ne perputhje me kontributin e tyre.
- 6.6.5 Vendors per krijimin e degeve ose filialeve sikurse dhe krijimin e shoqerive te perbashketa.
- 6.6.6 Vendors per marrjen e kredive, mbi bazen e propozimit te njerit prej administratoreve.
- 6.6.7 Miraton pagat e personelit te propozuara nga administratori i shoqerise.
- 6.6.8 Vendors me unanimitet per mbarimin e shoqerise ne se rezultatet e saj ne bilanc dalin me humbje, si dhe per shnderimin e shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne shoqeri te llojeve te tjera.

6.7. **Kompetencat e administratorit :**

- 6.7.1 Realizon marredheniet e ndryshme ekonomike me persona te tjere fizike dhe juridike.
- 6.7.2 Aprovon rregullat per sektore te ndryshem te veprimtarise se shoqerise, pasi merr mendimin e asamblese se ortakeve.
- 6.7.3 Shqyrton bilancin, kuotat, fondet e ndryshme si dhe fitimin dhe ia paraqet per aprovim asamblese se ortakeve..
- 6.7.4 Propozon pagat per personelin qe do te punesohet ne shoqeri.



6.7.5 Kujdeset per ndjekjen e problemeve te shoqerise me organet e ndryshme shteterore si dhe me persona te tjere fizike dhe juridike.

6.7.6 Kujdeset per funksionimin e perditshem dhe normal te shoqerise, koordinon veprimtarine e tij me stafin e teshoqerise.



## 7. MENYRA E PERFAQESIMIT

Shoqeria perfaqesohet nga administratori i saj ne te gjithë maredheniet juridike-civile, me persona te tjere juridike dhe fizike si dhe me organet e ndryshme shteterore. Shoqeria mund te perfaqesohet edhe nga persona te tjere te pajisur me autorizim te vecante te nenshkruar nga administratori.

## 8. FITIMI

8.1 Pas perballimit te detyrimeve, taksave, tatimeve, shpenzimeve te ndryshme pagave, ortakeve u mbetet ne dispozicion fitimi neto.

8.2 Fitimi neto mund te perdoret me rritjen e kapitalit themeltar me kontribute ne natyre, per zmadhimin e fondeve te shoqerise dhe per qellime te tjera ne pajtim me legjislacionin ne fuqi.

## 9. KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria krijohet per nje periudhe prej mbi (20 ) vjetesh.

10. **MAREDHENIET E PUNESIMIT**

Çdo person, do te punesohet ne shoqeri mbi bazen e kontrates se punes te lidhur ndermjet tij dhe administratorit, ne perputhje me legjislacionin e punes ne fuqi.



11. **PERGJEGJESIA E PUNONJESVE**

Çdo person i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte i detyruar te permbushë detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes, dhe vendimet e administratorit. Per shkelje te ndryshme, prej te cilave shoqerise mund t'i shkaktohen deme, ndaj çdo te punesuari mund merren masa te ndryshme deri ne largimin nga puna, perputhje me legjislacionin e punes ne fuqi.

12. **KONFIDENCIALITETI**

Ortaket, si dhe te gjithë personat qe do te perbejne personelin e shoqerise, jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit, te njohurive dhe pervojes se shkembyer, si dhe te çdo lloj materiali tjeter konfidencial dhe duhet te adaptoje te gjithë masat e nevojshme per te parandaluar perhapjen e tyre qofte dhe pjesisht.

13. **MBARIMI I SHOQERISE**

13.1 Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te organit drejtues te saj, nese aktiviteti i saj nuk rezulton fitimprures, si dhe per cdo shkak tjeter te parashikuar ne Ligj.

- 13.2 Shoqeria mund te mbaroje edhe me ane te riorganizimit nepermjet formave te ndarjes, dhe bashkimit.



14. **JURIDIKSIONI**

Çdo mosmarreveshje ndermjet ortakeve qe nuk mund te zgjidhet me pajtim, i referohet per shqyrtim Gjykates se Rrethit Tirane.

15. **DISPOZITA TE FUNDIT**

- 15.1 Viti financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor. Viti i pare financiar perfundon me 31.12.1999.

- 15.2 Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne institute sigurimi.

- 15.3 Shoqeria ka vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles percaktohen nga asambleja e ortakeve te shoqerise.

- 15.4 Ne mbledhjen e saj te pare asambleja e ortakeve zgjedhi si administrator te shoqerise :

**Zotin Artur Dushku.**

Statuti i shoqerise u aprovua nga Asambleja e Ortakeve sot me date 15 Qershor 1999.

Tirane, me 15.6.1999

**ORTAKET**

**SOKOL HOXHA**

**IRFAN HYSENBELLIU**

**ARTUR DUSHKU**

REPUBLIKA E SHQIPERSIE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 1656 Rep.  
Nr. 228 Kol

Tirane, me 14.06.1999



**VERTETIM**

Vertetohet se sot u paraqiten personalisht ne zyrën e noterise, para meje noterës  
**Kimete Peza :**

**Irfan Hysenbelliu** i datelindjes 8.4.1959, lindur ne Skrapar, me banim ne rrugen  
“Pjeter Bogdani”, P.11, Ap.6, Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te  
vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, mbajtes i pasaportes Nr.299990


**Sokol Hoxha**, i datelindjes 14.2.1951, lindur ne Tirane, me banim ne rrugen “Brigada  
e Tete”, Pall.8, Shk.3, Ap.35, Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te  
vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, mbajtes i leternjoftimit Nr.EV 219111.

**Artur Dushku**, i datelindjes 31.5.1955, lindur ne Tirane, me banim ne rrugen  
“Labinoti”, Pall.2, Shk.6, Ap.48 Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te  
vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, mbajtes i pasaportes Nr.0026421

Te lartepmendurit para meje me vullnet te lire dhe ne menyre te rregullt nenshkruan  
kete akt te shoqerise tregtare ne krijim e siper “ALCO-SYSTEMS” Shpk, dhe une  
noterja vertetoj nenshkrimin e rregullt te tyre.



**KONTRATA**  
**E THEMELIMIT TE SHOQERISE TREGTARE**  
**“ALCO-SYSTEMS” Shpk**



1. **HYRJE**

Kjo kontrate per themelimin e shoqerise tregtare  
“ALCO - SYSTEMS” Shpk, e cila qe ketu dhe me pas referohet  
si kontrate, lidhet ndermjet:

- 1.1 **Irfan Hysenbelliu** i datelindjes 8.4.1959, lindur ne Skrapar, me banim  
ne rrugen “Pjeter Bogdani”, P.11, Ap.6 , Tirane, madhor, me zotesi te  
plate juridike per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare ,  
mbajtes i pasaportes Nr.299990
- 1.2 **Sokol Hoxha**, i datelindjes 14.2.1951, lindur ne Tirane, me banim ne  
rrugen “Brigada e Tete”, Pall.8, Shk.3, Ap. 35, Tirane, madhor, me  
zotesi te plate juridike per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi  
shqiptare, mbajtes i leternjoftimit Nr.EV 219111.
- 1.3 **Artur Dushku**, i datelindjes 31.5.1955, lindur ne Tirane, me banim ne  
rrugen “Labinoti”, Pall.2, Shk.6, Ap.48 Tirane, madhor, me zotesi te  
plate juridike per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare,  
mbajtes i pasaportes Nr.0026421
- 1.4 Qellimi i kesaj kontrate eshte krijimi i shoqerise tregtare  
“ALCO-SYSTEMS” Shpk .
- 1.5 Objekti i veprimtarise se shoqerise pershkruhet ne nenin ( 2 ) te statutit  
te shoqerise qe i bashkelidhet kesaj kontrate dhe se bashku me te  
perbejne aktet themelore te shoqerise.

2. **STRUKTURA BAZE**



2.1 **Forma**

Ortakët themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në pajtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

2.2 **Emri**

Veprimtaria e shoqërisë do të kryhet nën emrin:  
Shoqëria Tregtare **“ALCO-SYSTEMS” Shpk**.

2.3 **Vendi i veprimtarisë**

Selia kryesore dhe vendi i ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë lokalizohet në Tiranë, Shqipëri.

2.4 **Afati**

Shoqëria do të fillojë veprimtarinë e saj nga data efektive dhe do të vazhdojë atë për më shumë se 20 vjet, nëse nuk përfundon më parë sipas menyrave të parashikuara në Ligj.

2.5 **Qëllimi i përgjithshëm**

Qëllimi për të cilin shoqëria organizohet është realizimi i objektivave që përshkruhen në statut

3.

### **PERCAKTIM**



Ne kete marreveshje dhe ne statut, nese nuk bie ne kundërshtim me kontekstin, fjalet dhe shprehjet e mëposhtme do te kene keto kuptime:

3.1

#### **Palet dhe ortakët:**

**Irfan Hysenbelliu** i datelindjes 8.4.1959, lindur ne Skrapar, me banim ne rrugen "Pjeter Bogdani", P.11, Ap.6 , Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare , mbajtes i pasaportes Nr.299990

**Sokol Hoxha**, i datelindjes 14.2.1951, lindur ne Tirane, me banim ne rrugen "Brigada e Tete", Pall.8, Shk.3, Ap. 35, Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, mbajtes i leternjoftimit Nr.EV 219111.

**Artur Dushku**, i datelindjes 31.5.1955, lindur ne Tirane, me banim ne rrugen "Labinoti", Pall.2, Shk.6, Ap.48 Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, mbajtes i pasaportes Nr.0026421

3.2

#### **Data efektive**

Date efektive do te nenkuptohet data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

3.3

### **Material konfidencial**

Me termin "material konfidencial" do te kuptohen te gjithë informacionet qe shkembepen ose qe mund te shkembepen ndermjet paleve, perfshire por jo kufizuar, ne te shkruar, te printuar, te fotografuar ose te medias elektronike dhe magnetike, qe ekzistojne tani ose qe mund te zhvillohen me vone, pavaresisht nga forma e komunikimit. Termi material konfidencial nuk perfshin informacionin , nese ka te tille, qe eshte ne zoterim publik ose qe mund te shkoje ne nje zoterim te tille.



4.

## **MARREVESHJA FINANCIARE**

### **Kapitali themeltar i ortakeve**

4.1

Çdo ortak ka kontribuar ne kapitalin themeltar te shoqerise sipas prcaktimit te bere ne nenin ( 4 ) te statutit.

4.2

### **Kontributet shtese te kapitalit**

Nese ne çdo kohe, gjate ekzistences se shoqerise, behet e nevojshme zgjerimi i kapitalit, me te cilin shoqeria eshte duke zhvilluar biznesin e saj, ne vendim te asamblese se ortakeve mund te vendoset shuma konkrete e zmadhimit te kapitalit.

4.3

### **Perqindja e fitimit dhe e kapitalit**

Perqindja e fitimit si dhe ajo e kapitalit do te jete ikurse eshte pershkruar ne paragrafin ( 4.2 ) te statutit.



4.4

#### **Interesi**

Asnje lloj interesi nuk do te paguhet per çdo kontribut ne kapitalin e shoqerise.



4.5

#### **Terheqja e kontributit ne kapital**

Asnje ortak nuk ka te drejte te kerkoje terheqjen e kontributit te tij te mundshem ne natyre te inkluduar ne kapitalin e shoqerise, me perjashtim te rasteve kur nje gje e tille eshte e parashikuar.

4.6

#### **Shperndarja**

Shperndarja e fitimit neto ortakeve, do te behet ne kohen kur asamblea e ortakeve do te vendose ne menyre te aresyeshme. Keto shperndarje do te behen ne te njejten kohe per te gjithë ortakët.

5.

#### **MBARIMI**

5.1

Ne rast se per çfaredo aresye shoqeria mbaron, do te behet nje llogari e pergjithshme e plote dhe e menjehershme e aktivitetit, pasivitetit dhe transaksioneve te saj. Pasurite e saj do te shiten "cash" sa me shpejt te jete e mundur dhe te gjithë huatë dhe shumat e tjera te shoqerise do te mblidhen.



5.2

**E drejta per te kerkuar prone**

Asnje ortak nuk do te kete te drejte te kerkoje pasuri  
(kontribute) ne natyre ne rast te shperndarjes se shoqerise.



Tirane, me 15.6.1999



**PALET**

**SOKOL HOXHA**

*Sokol Hoxha*  
*[Signature]*

**IRFAN HYSENBELLIU**

*Irfan Hysenbelliu*  
*[Signature]*

**ARTUR DUSHKU**

*Artur Dushku*  
*[Signature]*

